Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova
AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY
ARRU

UDHËZUESI DHE METODOLOGJIA PËR ZBATIMIN E TARIFËS SË MBINGARKESËS

Shtator 2026

Në mbështetje të nenit 4, paragrafi 3, nënparagrafi 3.6 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-088, si dhe nenit 12, paragrafi 8 të Rregullores Nr. 17/2026 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, nxjerr:

UDHËZUESIN DHE METODOLOGJINË PËR ZBATIMIN E TARIFËS SË MBINGARKESËS

Neni 1
Qëllimi

Ky Udhëzues përcakton metodologjinë, procedurat dhe kërkesat teknike, administrative, financiare dhe të raportimit për zbatimin e tarifës së mbingarkesës nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit në Kosovë, si dhe mënyrën e aplikimit të saj sipas shërbimit dhe diametrit të kyçjes.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Udhëzuesi zbatohet për ARRU-në dhe për të gjithë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujësjellësit dhe/ose ujërave të ndotura që aplikojnë tarifën e mbingarkesës.

2. Tarifa e mbingarkesës fillon të zbatohet më 1 janar 2027, në pajtim me nenin 31 të Rregullores Nr. 17/2026.

3. Tarifa e mbingarkesës aplikohet vetëm për shërbimin ose shërbimet në të cilat aplikuesi lidhet dhe regjistrohet si konsumator i ri.

Neni 3
Përkufizimet

1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Udhëzues kanë kuptimet si në vijim:

1.1. **Tarifa e mbingarkesës** – nënkupton tarifën për përforcimin e infrastrukturës, si pasojë e efekteve kumulative të ndërtimeve të shumta në rrjetin e ujësjellësit dhe/ose kanalizimit, e cila zbatohet për çdo konsumator të ri që lidhet në rrjet.

1.2. **Konsumator i ri** – nënkupton aplikuesin që aplikon për lidhje të re të autorizuar në rrjetin e ujësjellësit dhe/ose kanalizimit dhe, pas realizimit të lidhjes, regjistrohet si konsumator për shërbimin përkatës, në pajtim me Rregulloren Nr. 17/2026.

1.3. **Diametri i kyçjes** – nënkupton diametrin nominal të gypit/lidhjes së konsumatorit, të përcaktuar teknikisht nga ofruesi i shërbimeve, bazuar në kërkesën e arsyeshme për ujë dhe për të plotësuar standardet e shërbimit.

1.4. **Llogari e veçantë financiare** – nënkupton evidencën e ndarë kontabël dhe rregullatore për regjistrimin, përcjelljen dhe raportimin e të hyrave nga tarifa e mbingarkesës, si dhe destinimin/përdorimin e tyre.

1.5. **Kontribut kapital** – nënkupton të hyrat e realizuara nga tarifa e mbingarkesës, të dedikuara ekskluzivisht për investime kapitale për përforcimin, zgjerimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të rrjetit të ujësjellësit dhe/ose kanalizimit, të cilat trajtohen në përputhje me rregullat e kontabilitetit rregullator.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Udhëzues kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin përkatës për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe aktet nënligjore të nxjerra nga ARRU.

Neni 4

Parimet e zbatimit

1. Udhëzuesi zbatohet nga ARRU-ja dhe nga të gjithë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujësjellësit dhe/ose ujërave të ndotura, duke respektuar këto parime:

1.1. Ligjshmëria – tarifa e mbingarkesës zbatohet vetëm mbi bazën e akteve të ARRU-së dhe në shumën e miratuar.
1.2. Transparenca – konsumatori informohet paraprakisht për bazën, shumën, shërbimin dhe momentin e pagesës.
1.3. Reflektimi i kostos – tarifa e mbingarkesës lidhet me kostot e arsyeshme të rritjes së kapacitetit të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit.
1.4. Mosdiskriminimi – konsumatorët në kushte të njëjta trajtohen njësoj.
1.5. Proporcionaliteti – niveli i tarifës së mbingarkesës duhet të jetë i arsyeshëm në raport me kapacitetin e kërkuar dhe shërbimin që merret.
1.6. Ndalimi i financimit të dyfishtë – e njëjta kosto nuk duhet të mbulohet njëkohësisht nga tarifa e mbingarkesës dhe nga burime të tjera të njohura rregullatore pa rregullimin përkatës.

Neni 5

Dallimi nga tarifa/taksa komunale e infrastrukturës dhe nga tarifat e lidhjes

1. Tarifa e mbingarkesës nuk është taksë komunale. Taksa/tarifa komunale për infrastrukturë mbështetet në legjislacionin për ndërtim dhe financat e pushtetit lokal dhe lidhet me kostot e infrastrukturës komunale që bëhen të nevojshme si pasojë e zhvillimit.

2. Tarifa e mbingarkesës është tarifë sektoriale e shërbimeve të ujit dhe synon financimin e përforcimit, zgjerimit dhe përmirësimit të kapaciteteve të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përfshirë investime që mund të realizohen larg lokacionit ku zhvillohen ndërtimet e reja.

3. Tarifa e mbingarkesës është e veçantë nga tarifa për realizimin fizik të lidhjes së re dhe nga tarifa për inspektimin e lokacionit/pranimin teknik të lidhjes, të përcaktuara në Rregulloren Nr. 17/2026. Çdo tarifë e mbingarkesës paraqitet veçmas në faturë ose dokumentin e pagesës. Dallimet kryesore ndërmjet tarifës/taksës komunale të infrastrukturës dhe tarifës së mbingarkesës janë paraqitur në mënyrë të detajuar në Shtojcën 5 të këtij Udhëzuesi.

4. Ndikimi i ndërtimeve të reja në kapacitetet e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përfshirë nevojën për përforcimin ose zgjerimin e kapaciteteve në pjesë të sistemit që mund të ndodhen larg lokacionit të zhvillimit të ri, paraqitet në mënyrë ilustruese në Shtojcën 6 të këtij Udhëzuesi.

Neni 6

Metodologjia e llogaritjes së tarifës së mbingarkesës

1. Metodologjia e tarifës së mbingarkesës bazohet në pjesën e investimeve kapitale që lidhet me rritjen, zgjerimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit, duke përjashtuar përtëritjen e zakonshme të aseteve ekzistuese dhe aktivitetet e zakonshme operative.

2. Në përcaktimin e bazës së tarifës së mbingarkesës merret parasysh vetëm pjesa e investimeve kapitale që i atribuohet rritjes, zgjerimit dhe përmirësimit të kapaciteteve të infrastrukturës dhe që lidhet me nevojën për shtimin e kapaciteteve të rrjetit si pasojë e kyçjes së konsumatorëve të rinj.

3. Baza analitike, të dhënat, supozimet dhe llogaritjet e përdorura për përcaktimin e tarifës së mbingarkesës janë paraqitur në Shtojcën 1 të këtij Udhëzuesi.

Neni 7

Tarifa e mbingarkesës sipas diametrit të kyçjes

1. Në varësi të karakteristikave dhe nevojave të konsumatorëve, kyçjet në rrjetin e furnizimit me ujë realizohen përmes gypave të kyçjes me diametra të ndryshëm, sipas kërkesave teknike përkatëse.

2. Tarifa e mbingarkesës diferencohet sipas diametrit të gypit të kyçjes, me qëllim që aplikimi i saj të jetë reflektiv ndaj madhësisë së kyçjes.

3. Me rritjen e diametrit të gypit të kyçjes rritet edhe tarifa e mbingarkesës, sipas qasjes së përcaktuar në Shtojcën 2 të këtij Udhëzuesi.

4. Vlerat e tarifës së mbingarkesës sipas diametrit të kyçjes janë paraqitur në Shtojcën 3 të këtij Udhëzuesi.

5. Për konsumatorët me diametër të kyçjes mbi 250 mm, ofruesi i shërbimeve i drejtohet me shkrim ARRU-së dhe paraqet arsyetimin për metodologjinë e llogaritjes së tarifës së mbingarkesës.

Neni 8

Ndarja e tarifës së mbingarkesës sipas shërbimit

1. Tarifa ndahet ndërmjet shërbimit të ujësjellësit dhe shërbimit të ujërave të ndotura. Bazuar në të dhënat e aseteve të vitit 2024, ndarja është 83.76% për ujësjellës dhe 16.24% për kanalizim.

2. Konsumatori që lidhet vetëm në njërin shërbim paguan vetëm komponentin për atë shërbim. Nuk lejohet faturimi i komponentit të kanalizimit për konsumatorin që nuk merr atë shërbim, ose anasjelltas.

3. Përqindjet e ndarjes rishikohen nga ARRU kur të dhënat e bazës së aseteve ose metodologjia tarifore ndryshojnë materialisht. Ndarja e tarifës së mbingarkesës ndërmjet shërbimit të ujësjellësit

dhe shërbimit të ujërave të ndotura, sipas diametrit të kyçjes, është paraqitur në Shtojcën 4 të këtij Udhëzuesi.

Neni 9
Aplikimi i tarifës së mbingarkesës

1. Tarifa e mbingarkesës zbatohet për çdo aplikues për lidhje të re të autorizuar në rrjetin e ujësjellësit dhe/ose kanalizimit, i cili regjistrohet si konsumator i ri, sipas rasteve dhe kushteve në vijim:

1.1. Për lidhjen e re të një shtëpie të re të banimit, tarifa e mbingarkesës paguhet nga pronari i objektit në procesin e lidhjes dhe regjistrimit si konsumator i ri.

1.2. Për objektin shumëkatësh, tarifa e mbingarkesës paguhet individualisht nga secili konsumator i ri, për njësinë e veçantë për të cilën aplikohet për lidhje të re, instalohet ujëmatësi individual dhe bëhet regjistrimi si konsumator i ri, në pajtim me nenin 12, paragrafin 3 të Rregullores Nr. 17/2026.

1.3. Në objektin shumëkatësh, për secilën njësi përdoret diametri i lidhjes/ujëmatësit individual të asaj njësie, i përcaktuar nga ofruesi i shërbimeve në pajtim me rregullat teknike në fuqi. Diametri i gypit kryesor të objektit përdoret vetëm kur objekti regjistrohet si një konsumator i vetëm për atë lidhje.

1.4. Në rast të rindërtimit, zgjerimit ose zhvillimit të një prone ekzistuese, tarifa e mbingarkesës zbatohet vetëm atëherë kur, si rezultat i zhvillimit, realizohet lidhje e re dhe aplikuesi regjistrohet si konsumator i ri, në pajtim me rregullat për lidhjen dhe regjistrimin e konsumatorëve. Nëse numri i konsumatorëve brenda një prone të rindërtuar mbetet i njëjtë, atëherë nuk aplikohet tarifa e mbingarkesës.

1.5. Ndryshimi i pronarit ose i emrit të konsumatorit për një pronë me lidhje ekzistuese, për të cilën është krijuar detyrimi për tarifën e mbingarkesës, nuk krijon detyrim të ri për pagesën e tarifës së mbingarkesës. Zhvendosja e lidhjes ekzistuese, e realizuar në pajtim me rregullat në fuqi, gjithashtu nuk krijon detyrim të ri për këtë tarifë.

Neni 10
Procedura e zbatimit dhe faturimit të tarifës së mbingarkesës

1. Para se të faturohet tarifa e mbingarkesës ofruesi i shërbimeve verifikon aplikacionin për lidhje, statusin e konsumatorit të ri, shërbimin/shërbimet që do të merren dhe diametrin e aprovuar të kyçjes,

2. Ofruesi i shërbimeve e njofton me shkrim aplikuesin për aplikimin e tarifës së mbingarkesës, shumën e saj pa TVSH, TVSH-në sipas normës ligjore në fuqi, kur është e aplikueshme, shumën totale për pagesë, si dhe ndarjen e tarifës sipas shërbimit përkatës.

3. Tarifa e mbingarkesës paraqitet veçmas nga tarifa e lidhjes fizike, inspektimit, pranimit teknik dhe çdo tarifë tjetër e miratuar.

4. Ofruesi i shërbimeve regjistron në sistemin e faturimit kodin e tarifës së mbingarkesës, datën, shërbimin, diametrin, identifikimin e lidhjes/konsumatorit dhe dokumentin bazë.

5. Në rast gabimi material në faturim, ofruesi i shërbimeve korrigjon faturën sipas procedurave të saj dhe rregullave të ARRU-së, duke ruajtur gjurmën e auditimit.

Neni 11
Kushtet për zbatimin e tarifës së mbingarkesës

1. Në kuptim të nenit 12, paragrafi 6 të Rregullores Nr. 17/2026, ofruesi i shërbimeve konsiderohet i gatshëm për zbatim kur, së paku, ka:

1.1. Procedurë të brendshme të miratuar për identifikimin dhe faturimin e konsumatorëve të rinj;
1.2. Mundësi në sistemin e faturimit për regjistrimin e tarifës së mbingarkesës sipas shërbimit dhe diametrit;
1.3. Llogari të veçantë financiare/kontabël për të hyrat nga tarifa e mbingarkesës si dhe destinimin/përdorimin e tyre;
1.4. Plan të investimeve ku identifikohen investimet për rritjen dhe zgjerimin e kapaciteteve;
1.5. Kontrolle të brendshme që parandalojnë përdorimin e të hyrave për qëllime të tjera;
1.6. Format të raportimit rregullator të miratuar nga ARRU;
1.7. Njoftim publik dhe material informues për konsumatorët para fillimit të aplikimit.

Neni 12
Administrimi dhe trajtimi rregullator i të hyrave nga tarifa e mbingarkesës

1. Të hyrat nga tarifa e mbingarkesës dedikohen ekskluzivisht për financimin e investimeve kapitale që lidhen me përforcimin, zgjerimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit.

2. Ofruesi i shërbimeve krijon dhe mirëmban llogari të veçantë financiare për administrimin dhe evidentimin e të hyrave nga tarifa e mbingarkesës. Këto të hyra përdoren vetëm për investimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Ofruesi i shërbimeve krijon dhe mirëmban llogari financiare të veçantë, në të cilën arkëtohen të hyrat nga tarifa e mbingarkesës dhe nga e cila financohen investimet për rritjen, zgjerimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit.

4. Të hyrat nga tarifa e mbingarkesës trajtohen si kontribut i konsumatorëve në financimin e investimeve për përmirësimin dhe zgjerimin e kapaciteteve të infrastrukturës. Për qëllime të trajtimit rregullator, këto të hyra merren parasysh gjatë përcaktimit të Bazës Rregullatore të Aseteve (BRRA), me qëllim që pjesa e investimit e financuar nga tarifa e mbingarkesës të mos përfshihet si investim i financuar nga tarifat e rregullta të shërbimit.

5. Trajtimi i të hyrave nga tarifa e mbingarkesës në BRRA dhe në kërkesën për të hyra bëhet në përputhje me modelin dhe rregullat e përcaktimit të tarifave të ARRU-së.

Neni 13
Planifikimi, raportimi dhe monitorimi

1. Investimet e financuara nga tarifa e mbingarkesës duhet të jenë në harmoni me Planin e Biznesit, Planin Afatgjatë të Investimeve dhe Planin e Menaxhimit të Aseteve të ofruesit të shërbimeve, si dhe me vendimet tarifore të ARRU-së.

2. Ofruesi i shërbimeve i raporton ARRU-së së paku një herë në vit, ose më shpesh kur kërkohet, për:

2.1. numrin e konsumatorëve të rinj sipas kategorisë, shërbimit dhe diametrit;
2.2. të hyrat e faturuara dhe të arkëtuara nga tarifa e mbingarkesës;
2.3. gjendjen e llogarisë së veçantë financiare;
2.4. investimet e financuara ose bashkëfinancuara nga tarifa e mbingarkesës;
2.5. vlerën e investimeve të përfunduara dhe në proces;
2.6. trajtimin e kontributeve në BRRA/kërkesën për të hyra;
2.7. korrigjimet, rimbursimet dhe ankesat lidhur me tarifën e mbingarkesës.

3. ARRU monitoron dhe kontrollon zbatimin, dedikimin e të hyrave dhe përputhshmërinë me aktet rregullatore. Në rast mospërmbushjeje, ARRU ndërmerr masat e lejuara nga legjislacioni në fuqi, duke respektuar proporcionalitetin dhe procedurën e rregullt.

Neni 14
Informimi i konsumatorëve dhe ankesat

1. Ofruesi i shërbimeve njofton publikisht konsumatorët para fillimit të zbatimit të tarifës së mingarkesës dhe siguron që kushtet, tarifat dhe mënyra e llogaritjes të jenë të qasshme në gjuhët zyrtare.

2. Konsumatori duhet të marrë informacion të mjaftueshëm përpara pagesës, përfshirë shumën përfundimtare dhe ndarjen e tarifës së mbingarkesës sipas shërbimit.

3. Ankesa lidhur me aplikimin ose faturimin e tarifës së mbingarkesës paraqitet fillimisht te ofruesi i shërbimeve dhe më pas, sipas kushteve ligjore, mund t'i drejtohet ARRU-së në pajtim me legjislacionin për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe rregullat për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.

Neni 15
Dispozitat kalimtare

1. Ofruesit e shërbimeve duhet t'i përfundojnë përgatitjet teknike, administrative dhe financiare, si dhe informimin e konsumatorëve, para datës 1 janar 2027.

2. Tarifa e mbingarkesës zbatohet nga data 1 janar 2027 për aplikuesit që nga kjo datë aplikojnë për lidhje të re të autorizuar në rrjetin e ujësjellësit dhe/ose kanalizimit dhe, pas realizimit të lidhjes, regjistrohen si konsumatorë të rinj për shërbimin përkatës.

3. Tarifa e mbingarkesës nuk zbatohet në mënyrë retroaktive për detyrime që kanë lindur para datës 1 janar 2027. Për rastet kalimtare të iniciuara para kësaj date, në të cilat lidhja ose regjistrimi përfundon pas kësaj date, ofruesi i shërbimeve vepron në pajtim me kriteret e Rregullores Nr. 17/2026 dhe, kur ka paqartësi, kërkon sqarim nga ARRU para faturimit.

4. ARRU mund ta rishikojë dhe plotësojë këtë Udhëzues në rast të ndryshimit të legjislacionit, metodologjisë tarifore ose kur praktika e zbatimit dëshmon nevojën për ndryshim apo plotësim.

5. Në rast të mospërputhjes së dispozitave të këtij Udhëzuesi me Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të ndryshuar dhe plotësuar, ose me Rregulloren Nr. 17/2026 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë, zbatohen dispozitat e aktit juridik me fuqi më të lartë.

Neni 16
Shtojcat dhe zbatimi i tarifës së mbingarkesës

1. Shtojcat e këtij Udhëzuesi paraqesin metodologjinë, bazën analitike, mënyrën e llogaritjes dhe ndarjen e tarifës së mbingarkesës, në funksion të zbatimit të këtij Udhëzuesi.

2. Vlerat monetare të tarifës së mbingarkesës të paraqitura në shtojcat e këtij Udhëzuesi zbatohen vetëm pasi të jenë përcaktuar dhe miratuar me Urdhëresën Tarifore të Shërbimit (UTSH), në pajtim me legjislacionin dhe rregullat tarifore në fuqi.

3. Për vitin 2027, vlerat e paraqitura në shtojcat e këtij Udhëzuesi zbatohen në masën që ato përcaktohen dhe miratohen me Urdhëresën Tarifore të Shërbimit përkatëse.

4. Në rast të ndryshimit të vlerave të tarifës së mbingarkesës me Urdhëresën Tarifore të Shërbimit, zbatohen vlerat e përcaktuara në UTSH, pa qenë e nevojshme ndryshimi i këtij Udhëzuesi, për aq kohë sa nuk ndryshon metodologjia ose mënyra e zbatimit të tarifës.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzues publikohet në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe hyn në fuqi më 1 janar 2027.

Datë 12/10/2026

Prishtinë

Zëvendësdrejtori i ARRU

Abedin AZIZI

SHTOJCA 1 – Metodologjia e përcaktimit të tarifës së mbingarkesës

1. Tarifa e mbingarkesës bazohet në pjesën e investimeve kapitale që lidhet me rritjen, zgjerimin ose përmirësimin e kapaciteteve, dhe jo me përtëritjen e zakonshme të aseteve ekzistuese ose aktivitetet e zakonshme operative.

2. Sipas bazës analitike, investimi minimal sektorial është vlerësuar në 15.00 EUR për konsumator në vit (10.00 EUR për ujësjellës dhe 5.00 EUR për kanalizim). Nga kjo shumë, 7.50 EUR janë trajtuar si pjesë për përtëritje dhe 7.50 EUR për rritje kapitale, mirëmbajtje kapitale dhe në aktivitete biznesore; nga pjesa e dytë, 2.00 EUR për konsumator është alokuar për investimet që lidhen me rritjen, zgjerimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të infrastrukturës.

3. Duke përdorur 481,510 konsumatorë, sipas të dhënave të vitit 2024, baza vjetore e investimeve për rritje rezulton: 481,510 × 2.00 EUR = 963,020 EUR.

4. Duke përdorur mesataren prej 21,035 konsumatorësh të rinj në pesë vitet e fundit, vlera mesatare e tarifës së mbingarkesës rezulton: 963,020 EUR / 21,035 = 45.78 EUR për konsumator të ri.

5. Duke marrë parasysh se kyçjet realizohen me diametra të ndryshëm, tarifa e mbingarkesës diferencohet sipas diametrit të gypit të kyçjes. Për diametrat 15 mm, 20 mm dhe 25 mm është përcaktuar tarifa bazë prej 45.02 EUR për kyçje, pa TVSH, e cila shërben si pikënisje për diferencimin e tarifave të mbingarkesës për diametrat e tjerë të kyçjes, sipas madhësisë së gypit.

6. Pavarësisht diferencimit të tarifës së mbingarkesës sipas diametrit të kyçjes, vlera totale e të hyrave nga tarifa e mbingarkesës për konsumatorët e rinj kufizohet në shumën prej 963,020 EUR, në përputhje me bazën vjetore të investimeve për rritje të përcaktuar sipas paragrafit 3 të kësaj Shtojce

SHTOJCA 2 – Tarifa e mbingarkesës sipas diametrit të kyçjes

1. Në varësi të karakteristikave dhe nevojave të konsumatorëve, kyçjet në rrjetin e furnizimit me ujë realizohen përmes gypave të kyçjes me diametra nga 15 mm deri në 250 mm.

2. Tarifa e mbingarkesës diferencohet sipas diametrit të gypit të kyçjes, me qëllim që tarifa të jetë reflektive ndaj madhësisë së kyçjes.

3. Me rritjen e diametrit të gypit të kyçjes rritet edhe tarifa e mbingarkesës, në mënyrë proporcionale sipas madhësisë së gypit.

4. Për diametrat 15 mm, 20 mm dhe 25 mm aplikohet tarifa bazë prej 45.02 EUR për kyçje, pa TVSH. Kjo tarifë shërben si pikënisje për diferencimin e tarifave për diametrat e tjerë të kyçjes.

5. Tarifat e mbingarkesës sipas diametrit të gypit të kyçjes, nga 15 mm deri në 250 mm, janë përcaktuar në Shtojcën 3 të këtij Udhëzuesi.

6. Për konsumatorët me diametër të kyçjes mbi 250 mm, ofruesi i shërbimeve i drejtohet me shkrim ARRU-së dhe paraqet arsyetimin për metodologjinë e llogaritjes së tarifës së mbingarkesës.

SHTOJCA 3 – TARIFAT E MBINGARKESËS SIPAS DIAMETRIT TË KYÇJES

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e Udhëzuesit dhe paraqet tarifat e mbingarkesës sipas diametrit të kyçjes, në zbatim të nenit 7 të këtij Udhëzuesi.

Nr.	Diametri (mm)	Njësia	Totali pa TVSH (EUR)
1	15	EUR/kyçje	45.02
2	20	EUR/kyçje	45.02
3	25	EUR/kyçje	45.02
4	32	EUR/kyçje	47.58
5	40	EUR/kyçje	74.35
6	50	EUR/kyçje	116.17
7	65	EUR/kyçje	196.33
8	80	EUR/kyçje	297.40
9	100	EUR/kyçje	464.69
10	125	EUR/kyçje	726.07
11	150	EUR/kyçje	1,045.55
12	200	EUR/kyçje	1,359.21
13	250	EUR/kyçje	1,766.97

SHTOJCA 4 – NDARJA E TARIFËS SË MBINGARKESËS SIPAS SHËRBIMIT

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e Udhëzuesit dhe paraqet ndarjen e tarifës së mbingarkesës ndërmjet shërbimit të ujësjellësit dhe shërbimit të ujërave të ndotura, sipas diametrit të kyçjes, në zbatim të nenit 8 të këtij Udhëzuesi.

Nr.	Diametri (mm)	Ujësjellës pa TVSH	Kanalizim pa TVSH	Totali pa TVSH
1	15	37.71	7.31	45.02
2	20	37.71	7.31	45.02
3	25	37.71	7.31	45.02
4	32	39.86	7.73	47.58
5	40	62.28	12.07	74.35
6	50	97.31	18.86	116.17
7	65	164.45	31.88	196.33
8	80	249.11	48.29	297.40
9	100	389.23	75.45	464.69
10	125	608.18	117.90	726.07
11	150	875.78	169.77	1,045.55
12	200	1,138.51	220.70	1,359.21
13	250	1,480.06	286.91	1,766.97

SHTOJCA 5 – DALLIMI NDËRMJET TARIFËS/TAKSËS KOMUNALE TË INFRASTRUKTURËS DHE TARIFËS SË MBINGARKESËS

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e Udhëzuesit dhe paraqet në mënyrë të përmbledhur dallimet kryesore ndërmjet tarifës/taksës komunale të infrastrukturës dhe tarifës së mbingarkesës, në zbatim të nenit 5 të këtij Udhëzuesi.

Kriteri i krahasimit	**Taksa/tarifa komunale e infrastrukturës**	**Tarifa e mbingarkesës (ARRU)**
Baza juridike	Legjislacioni për ndërtim dhe financat e pushtetit lokal	Legjislacioni sektorial i shërbimeve të ujit dhe Rregullorja Nr. 17/2026
Qëllimi	Infrastrukturë komunale e lidhur me zhvillimin	Kapacitet shtesë/përforcim i sistemit të ujit dhe kanalizimit
Organi kompetent	Komuna, brenda autorizimeve ligjore	ARRU përcakton/miraton; ofruesi i shërbimeve zbaton
Përfituesi financiar	Sipas rregullave komunale	Ofruesi i shërbimeve, vetëm për investimet e dedikuara

SHTOJCA 6 - SKEMA ILUSTRUESE E NDIKIMIT TË NDËRTIMEVE TË REJA NË KAPACITETET E RRJETIT TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT



Figura 1 – Ndikimi i ndërtimeve të reja në kapacitetet e rrjetit të ujësjellësit



Figura 2 – Ndikimi i ndërtimeve të reja në kapacitetet e rrjetit të kanalizimi